

**VENDIM**  
**Nr. 55, datë 1.2.2023**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR LIRINË E LËVIZJES ME KARTË  
IDENTITETI NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes me kartë identiteti në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**MARRËVESHJE**  
**PËR LIRINË E LËVIZJES ME KARTË IDENTITETI NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

Përfaqësuesit e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës<sup>1</sup>, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (në vijim të referuara si Palët dhe individualisht si Palë),

*të udhëhequr* nga parimet e ligjit të BE-së, vlerat evropiane dhe praktikat e mira të BE-së për të përmirësuar më tej bashkëpunimin dhe përpjekjen për të lehtësuar reciprokisht kushtet e udhëtimit dhe marrëdhëniet e mira, duke thjeshtuar procedurën administrative për hyrjen, transitin, daljen dhe qëndrimin e shkurtër të personave fizikë/mbajtësve të kartave të identitetit brenda Ballkanit Perëndimor,

*duke shprehur* vullnetin për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike, investimet dhe punësimin në Ballkanin Perëndimor,

*duke marrë parasysh* rëndësinë e lëvizjes së lirë të personave fizikë/mbajtësve të kartave të identitetit për të garantuar progres dhe prosperitet ekonomik për një Ballkan Perëndimor të fortë dhe të lulëzuar, duke dhënë një kontribut të domosdoshëm në perspektivën evropiane të rajonit,

*duke pasur në vëmendje* konkluzionet e miratuara nga liderët në kuadër të Procesit të Berlinit, duke theksuar vizionin e prosperitetit që shtetasit e Ballkanit Perëndimor të gëzojnë të njëjtat liri si qytetarët evropianë,

*duke marrë në konsideratë* Deklaratën e Liderëve të Ballkanit Perëndimor për Tregun e Përbashkët Rajonal – një katalizator për një integrim më të thellë ekonomik rajonal dhe një hap drejt Tregut të Vetëm të BE-së, të miratuar në Samitin e liderëve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit, të mbajtur në Sofje, më 10 nëntor 2020,

*të bindur* se bashkëpunimi rajonal do të kontribuojë në ndërtimin e shoqërive të bazuara në demokraci, sundim të ligjit dhe respekt për të drejtat e njeriut,

*duke marrë parasysh* rëndësinë që Palët i kushtojnë luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal,

*duke njohur* se të gjitha Palët janë në rrugën evropiane dhe se ky bashkëpunim rajonal nuk synon të dyfishojë apo zëvendësojë BE-në dhe se kjo marrëveshje nuk ka nevojë për institucione që nxjerrin legjislacion.

---

<sup>1</sup> Ky emërtim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e ICJ-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Bien dakord si më poshtë:

#### Neni 1

### Dispozita të përgjithshme

I. Kjo Marrëveshje parashikon të njëjtat kushte për hyrjen, transitin, daljen dhe qëndrimin e shkurtër të personave fizikë/mbajtësve të kartave të identitetit.

II. Personat fizikë/mbajtësit e kartave të identitetit për të cilët zbatohet kjo Marrëveshje do të kenë, për periudhën e specifikuar në këtë Marrëveshje, të drejtën për të hyrë, për të kaluar transit, për të dalë dhe për qëndrim të shkurtër në cilëndo nga Palët.

III. Kjo Marrëveshje zbatohet vetëm për personat fizikë/mbajtësit e kartave të identitetit të Palëve dhe nuk zbatohet për personat fizikë/mbajtësit e kartave të identitetit që nuk marrin pjesë në këtë Marrëveshje, të cilët kanë rregulluar qëndrimin në njërën nga Palët.

IV. Pa cenuar paragrafin I të këtij neni, personat nën moshën 16 vjeç kanë të drejtë të hyjnë, kalojnë transit, dalin dhe për një qëndrim afatshkurtër në cilëndo nga Palët sipas legjislacionit përkatës.

#### Neni 2

### Përkufizimet

Termat e mëposhtëm do të përdoren për këtë Marrëveshje:

1. “Person fizik/mbajtës i kartës së identitetit” – personi fizik që posedon kartën e identitetit të njëres prej Palëve;

2. “Legjislacion i Palëve dhe masa administrative” – ligjet përkatëse dhe rregulloret e tjera që janë në fuqi në palët përkatëse;

3. “Kartë identiteti” – kartë identiteti e vlefshme me zonë të lexueshme nga makineritë me të paktën 90 ditë vlefshmëri, pas datës së synuar të nisjes nga Pala përkatëse pritëse;

4. “Pala Pritëse” – një Palë në të cilën një person me kartë identiteti hyn (trafik tokësor, detar ose ajror), kalon transit ose qëndron për një qëndrim të shkurtër, siç konsiderohet nga kjo Marrëveshje;

5. “Qëndrim i shkurtër” - jo më shumë se 90 ditë në çdo periudhë 180-ditore që përfshin 180 ditë para çdo dite qëndrimi.

#### Neni 3

### Hyrja, transiti, dalja dhe qëndrimi i shkurtër

I. Palët do të garantojnë që personi fizik/mbajtësi i kartës së identitetit të ketë të drejtën për të hyrë, kaluar tranzit, për të dalë dhe për qëndrim të shkurtër në secilën prej Palëve sipas dispozitave të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

II. Personit për të cilin zbatohet paragrafi I i këtij neni, nuk do t'i vendoset vizë hyrjeje, transiti dhe daljeje ose formalitet ekuivalent.

III. Kjo Marrëveshje nuk cenon dhe nuk derogon asnjë masë, praktikë ose marrëveshje të mëparshme ndërmjet dy ose më shumë Palëve që është më e dobishme për personat fizikë/mbajtësit e kartave të identitetit dhe nuk paraqet pengesë për vendosjen e ndonjë mase ose marrëveshje të tillë të mëtejshme.

#### Neni 4

I. Një person fizik/mbajtës i kartës së identitetit ka të drejtë të hyjë, të kalojë transit ose të qëndrojë për një periudhë afatshkurtër brenda një Pale tjetër, nëse:

1. Ai/ajo ka një kartë identiteti të vlefshme. Në një rast të justifikuar emergjence, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës të Palës Pritëse, nga ky detyrim mund të hiqet dorë;

2. Ai/ajo nuk ka ndalim hyrjeje të lëshuar nga njëra nga Palët;

3. Ai/ajo nuk konsiderohet të jetë kërcënim për rendin, sigurinë ose shëndetin publik, si dhe për arsye të tjera sipas rregullave përkatëse të Palës Pritëse;

II. Standardizimi i leximit elektronik të një karte identiteti dhe regjistrimi i të dhënave do të kryhet sipas legjislacionit të Palës marrëse.

#### Neni 5

Çdo Palë do të rezervojë të drejtën të refuzojë hyrjen dhe të revokojë transitin ose qëndrimin afatshkurtër sipas arsyeve të parashikuara në nenin 4, paragrafi I.

#### Neni 6

I. Palët do të shkëmbejnë ekzemplarë të kartave të identitetit jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet Depozitarit të Marrëveshjes.

II. Në rast të modifikimit, revokimit ose prezantimit të llojeve të reja të kartave të identitetit, Palët do të dorëzojnë ekzemplarë përmes Depozitarit jo më vonë se 30 ditë pas modifikimit të paraqitur dhe do të japin informacionin e nevojshëm në lidhje me kushtet e tyre të përdorimit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 7

Në rast të humbjes së kartës së identitetit, mbajtësit të saj do t'i mundësohet të largohet nga Pala Pritëse me dokumente të përshtatshme udhëtimi të lëshuara nga autoritetet kompetente.

#### Neni 8

##### **Komisioni**

Një komision do të krijohet dhe do të ngarkohet me organizimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve në lidhje me implementimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 9

I. Komisioni do të përbëhet nga dy përfaqësues të secilës Palë.

II. Puna e Komisionit do të koordinohet nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC).

III. Komisioni do të miratojë rregullat e tij të procedurës pas krijimit të tij.

#### Neni 10

I. Komisioni do të mbledhet të paktën një herë në vit dhe do t'u raportojë Palëve çdo gjashtë muaj për implementimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

II. Komisioni do të mbledhet gjithashtu me kërkesë të njëres prej Palëve.

III. Të gjitha vendimet e Komisionit do të merren me konsensus të të gjitha Palëve.

#### Neni 11

##### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

I. Kjo Marrëveshje do të ndryshohet vetëm me pëlqimin e të gjitha Palëve, duke iu nënshtruar të njëjtës procedurë të nevojshme për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje.

II. Të gjitha çështjet shtesë që lidhen me implementimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të rregullohen nëpërmjet protokolleve të dakordësuara nga Komisioni i krijuar sipas nenit 8.

#### Neni 12

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind nga implementimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, të diskutohet brenda Komisionit të krijuar sipas nenit 8.

#### Neni 13

#### **Hyrja në fuqi**

I. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit sipas kërkesave të parashikuara nga legjislacioni përkatës i Palëve. Njoftimi zyrtar i ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohet te Depozitari sipas paragrafit IV të këtij neni.

II. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë) pas depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit për ato Palë që kanë depozituar njoftimin e tyre zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

III. Për çdo Palë që depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit pas datës së depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës kur kjo Palë depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

IV. Maqedonia e Veriut do të veprojë si Depozitar dhe do të njoftojë të gjitha Palët për çdo njoftim të marrë sipas këtij neni dhe për çdo akt ose njoftim tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

#### Neni 14

Nëse njëra Palë tërhiqet nga kjo Marrëveshje, ajo do të pushojë së qeni efektive vetëm për atë Palë, brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të njoftimit të saj te Depozitari.

#### Neni 15

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën angleze në një version origjinal, që do të mbetet në zotërim të Depozitarit. Secila Palë do të marrë një kopje të verifikuar të Marrëveshjes.

Bërë në \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_ 2022.

[Nënshkrimet]